



QKB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANE
ZYRA NOTERISE TIRANE

Noter Erjon B.BARDHI

Nr. 393 Rep

Nr. 145 Kol

Taksa e pulles e paguar.

**KONTRATE SHIT-BLERJE E PASURISË E LUAJTSHME
(SHITJE KUOTASH)**

Sot më datë 24/01/2019 (dymijë e nentembëdhjetë) para meje Noter **Erjon B.Bardhi** anëtar i Dhomës së Noterëve Tirane i regjistruar pranë Organeve Tatimore QKB me numer Nipti L62227014R, në zyrën noteriale të ndodhur në "Rr.Kongresi i Permetit" Zogu i Zi, perballe Ring Center, Tirane u paraqiten personalisht palet e meposhtme të cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

PALA SHITËSE: 1-AUREL HOXHA atesia BAJRAM i lindur në Elbasan me datë 14.11.1991 dhe banues në njesia bashkiake nr 2, Tirane madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me pasaporten me nr personal J11114063N, në cilesine e ortakut të 1 kuote me pjesemarrje në përqindje 33.33 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.

2-ERMAL ASLLANI atesia BARDHYL i lindur në Peshkopi, Diber me datë 13.06.1987 dhe banues në njesia bashkiake nr 9, Tirane madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me pasaporten me nr personal I70613070J, në cilesine e ortakut të 1 kuote me pjesemarrje në përqindje 33.33 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.

3-EGLI HYSENLLARI atesia LAVDERIM i lindur në Pogradec me datë 07.05.1989 dhe banues në njesia bashkiake nr 2, Tirane madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Leternjoftimin me nr personal I90507074K, në cilesine e ortakut të 1 kuote me pjesemarrje në përqindje 33.34 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësit");

BLERESI: FLORIAN PALAJ atesia KIN i lindur në Dajç, Shkodër me datë 23.04.1988 dhe banues në Dajç, Shkodër madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Leternjoftimin me nr personal I80423050R. (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësit dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

Shoqëria "BEER HOUSE" sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e qe funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L82219002C, me kapital themeltar prej 1500 (njemije e peseqind)leke të reja të ndarë në 3 kuota dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar Shitësit zotërojnë:

1. AUREL HOXHA zotërues i 1 (nje) kuote në pjesemarrje në përqindje 33.33 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
2. EGLI HYSENLLARI zotërues i 1 (nje) kuote në pjesemarrje në përqindje 33.34 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
3. ERMAL ASLLANI zotërues i 1 (nje) kuote në pjesemarrje në përqindje 33.33 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.



Adresa: Rr. "Kongresi i Permetit" Zogu i Zi, Perballe Ring Center, Tirane

Tel: 0694788331

(Handwritten signatures and initials)

Shitësit i kane njoftuar Blerësit ofertën e tyre për shitjen e 25% (njezet e pese perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe Blerësi ka pranuar të blejë pjesëmarrjen e ofruar nga Shitësit në Shoqëri;

- a. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësit se bashku i shesin Blerësit 25% (njezet e pese perqind) te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk dhe konkretisht:

- 8.33% (tete presje tridhjetete e tre) perqind te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk qe zoteron ortaku Aurel Hoxha.
- 8.34% (tete presje tridhjetete e kater) perqind te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk qe zoteron ortaku Egli Hysenllari.
- 8.33% (tete presje tridhjetete e tre) perqind te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk qe zoteron ortaku Ermal Asllani.

Blerësi z.Florian Palaj blen 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 25% (njezet e pese) perqind te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk

Neni 2

Çmimi

- 2.1. Shitësit i shesin 25 % (njezet e pese perqind) te kapitalit themeltar bleresit z.Florian Palaj kundrejt cmimit 375 (treqind e shtatedhjetete e pese) leke te reja dhe perkatesisht:

- 8.33% (tete presje tridhjetete e tre) perqind nga 33.33 % (tridhjetete e tre presje tridhjetete e tre perqind) te kapitalit themeltar, te 1 (nje) kuote qe zoteron shitesi z. Aurel Hoxha, ja shet bleresit z.Florian Palaj ne vleren 125 (njeqind e njezet e pese leke).
- 8.34% (tete presje tridhjetete e kater) perqind nga 33.34 % (tridhjetete e tre presje tridhjetete e kater perqind) te kapitalit themeltar, te 1 (nje) kuote qe zoteron shitesi z. Egli Hysenllari, ja shet bleresit z.Florian Palaj ne vleren 125 (njeqind e njezet e pese leke).
- 8.33% (tete presje tridhjetete e tre) perqind nga 33.33 % (tridhjetete e tre presje tridhjetete e tre perqind) te kapitalit themeltar, te 1 (nje) kuote qe zoteron shitesi z. Ermal Asllani, ja shet bleresit z.Florian Palaj ne vleren 125 (njeqind e njezet e pese leke).

Palët deklarojnë se çmimi është paguar i plotë jashtë kësaj zyre noteriale nga blerësi në favor të shitësive, të cilët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

Neni 3

Deklarimet dhe garancitë

- 3.1 Shitësit deklarojne dhe vërtetojne se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ata zotërojnë pjesëmarrjen e transferuar sipas kësaj Kontrate, dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave jane Shitësit
- 3.2. Blerësi deklaron dhe vërteton se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

Neni 4

Transferimi i të drejtave



- 1.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pavarësisht mënyrës se pagesës se çmimit te shitjes. Kjo Kontrate nuk është dhe ne asnjë rast nuk do te interpretohet si nje kontrate shitje me rezerve pronësie. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar.
- 1.2. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk do te jete:
1. AUREL HOXHA zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 25 % te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
 2. EGLI HYSENLLARI zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 25 % te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
 3. ERMAL ASLLANI zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 25 % te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
 4. FLORIAN PALAJ zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 25 % te kapitalit themeltar te Shoqërisë "BEER HOUSE" shpk.
- 1.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në Regjistrin Tregtar si dhe pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5
Të ndryshme

- 5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolare apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, te ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Unë noter Erjon B.Bardhi, hartova këtë kontratë, në 5(pese) kopje ne gjuhën shqipe, që pasi u lexua nga ana ime dhe palët pjesëmarrëse, të cilat deklaruan para meje së është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar, në shenjë pranimi e nënshkruan në praninë time. Duke qenë i bindur për identitetin e palëve dhe vullnetin e tyre të lirë unë Noter Erjon B.Bardhi e legalizoj aktin e mësipërm në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 51 të ligjit nr. 7829, date 1.06.1994 "Për Noterinë", i ndryshuar, në 5(pese) kopje me vlerë të njëjtë, nga të cilat,nje kopje dorezohet prane QKB-se, nje kopje i jepet palës blerëse, dy kopje palës shitëse dhe një kopje administrohet nga ana ime,prane kesaj zyre Noterie.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

PALA SHITËSE

1-AUREL HOXHA

Aurel Hoxha

2-ERMAL ASLLANI

Ermal Asllani

3-EGLI HYSENLLARI

Egli Hysenllari



NOTER
ERJON B.BARDHI

PALA BLERËSE

FLORIAN PALAJ

Florian Palaj



Regjistri i Barreve Siguruese


Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20190124163644175
Data e Rezultatit te Kerkimit: 24.01.2019
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 4:36:44PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-613-2940
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ERMAL BARDHYL ASLLANI
BEER HOUSE SH.P.K.
AUREL BAJRAM HOXHA
EGLI LAVDERIM HYSENLLARI



Aranda Zekaj